

Në bazë të dispozitave të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 18 të Ligjit nr. 04/L-110 të Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 21 të Ligjit nr.04/L-174 për Plnifikim Hapësinor, nenit 20, paragrafi 6 të Udhëzimit administrativ nr. 06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II- të ndërtimeve, duke vendosur sipas kërkesës 05 nr.350/05-12252/21 dt.20.01.2021, të pronarit/investitorit “Chelsea Point” L.L.C nga Prishtina për plotësimin dhe ndryshimin e Zgjidhjes Urbane të miratuar me Vendimin 05 nr.350-4138 dt.20.03.2021 e kushteve ndërtimore, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative me dt.26.05.2021, merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIM TË NDRYSHIMIT DHE PLOTËSIMIT TË ZGJIDHJES URBAE TË MIRATUAR ME VENDIMIN 05 nr.350-4138 dt.20.03.2013 e KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. Miratohet ndryshimi dhe plotësimi i Zgjidhjes Urbane të miratuar me Vendimin 05 nr.350-4138 dt.20.03.2013 e kushteve ndërtimore, sipas kërkesës 05 nr.350/05-12252/21 dt.20.01.2021 të pronarit/investitorit “Chelsea Point” L.L.C nga Prishtina, për parcelat kadastrale 1340/11, 12, 13, 14 dhe 1342-13 të bllokut “A”, parcelat kadastrale 1338/1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 20, 21, 22, 23 si dhe parcelat kadastrale 1339/1, 2, 3 dhe 4 Z.K Bërnice e epërme të bllokut “B”, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë.

II. Ndryshimi dhe plotësimi bazohet në Planin Zhvillimor Urban, miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013, ku kjo zonë është e planifikuar me destinim “Banim individual”.

III. Ndryshimi dhe plotësimi bëhet me bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrale 1340/11, 12, 13, 14 dhe ndarjen e parcelës 1342-13 të bllokut “A” si dhe me bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrale 1338/1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 20, 21, 22, dhe 23 si dhe parcelat kadastrale 1339/1, 2, 3 dhe 4 Z.K Bërnice e epërme të bllokut “B”. Ndryshimi i bllokut “A” përfshin parcelat me 8 shtëpi me etazhitet P+1 dhe B+P+1 të projektuara si shtëpi dyshe, pjesa tjetër e bllokut është e realizuar. Ndërsa blloku “B” përbëhet nga 13 shtëpi të veçanta me etazhitet B+P+1 (vetëm një shtëpi është e ndërtuar) dhe 16 shtëpi me etazhitet B+P+1 të riorganizuar si shtëpi dyshe, qendra e komunitetit me etazhitet B+P+2, parku i komunitetit me përmbajtje të sportit dhe rekreacionit dhe rruga e bllokut me profil 11m’.

IV. Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore-brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhësës ose suterrenit, sipas PZHU-së, për banim individual është

0.2-0.3 ndërsa koeficienti i ndërtimit (ISPN) është 0.6-0.8 me etazhitet maksimal P+2.

Bazuar në këta parametra tipet e shtëpive brenda lagjes janë:

- Tipi "A" 235 m² me dimeziona 11m x 7m
- Tipi "B" 300 m² me dimeziona 10m x 10m
- Tipi "C" 265 m² me dimeziona 12m x 7m
- Tipi "D" 160 m² me dimeziona 10m x 8m
- Tipi "A" 195 m² me dimeziona 10m x 6.5m
- Qendra e komunitetit 1200 m²
- Lokali ekzistues "Bistro" ~ 135 m².

V. Meqenëse Kushtet ndërtimore për këtë lagje janë miratuar para miratimit të PZHU-së, ky plotësim ndryshim duhet të plotësohet edhe me disa pika si në vijim:

VI. Bashkimi dhe ndarja e parcelave kadastrale nr.1340/11, 12, 13, 14 dhe ndarja e parcelës 1342-13 të bllokut "A", parcelave kadastrale 1338/1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 20, 21, 22, dhe 23 si dhe parcelave kadastrale 1339/1, 2, 3 dhe 4 Z.K Bërnice e epërme të bllokut "B", do të realizohet sipas zgjidhjes urbane dhe vijës rregulluese të planifikuar të përcaktuar sipas Manualit të bashkimit dhe ndarjes punuar nga gjeodeti i licencuar Ibrahim Jonuzi me licencë nr.105.

Kjo Drejtori përmes këtij paragrafi jep PËLQIM për bashkimin dhe ndarjen e parcelave kadastrale të lartë cekura, sipas Manualit të bashkimit dhe ndarjes punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e bashkimit dhe ndarjes do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit dhe ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarit/ investitorit, duke u bazuar edhe në, Planin e situacionit - "zgjidhjen urbane", e i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore.

VII. Dokumentacioni ndërtimor për Leje Mjedisore Komunale të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në Drejtorinë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm. Njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore, dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Raporti për Leje Mjedisore Komunale, në tre (3) kopje në formë të shkruar dhe një (1) në formë elektronike;
- Certifikatën për regjistrimin e biznesit;
- Certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit;
- Kontratën për shfrytëzimin e parcelës, nëse parcela nuk është pronë e aplikuesit.

VIII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcelat kadastrale nr.1340/11, 12, 13, 14, 1342-13, 1338/1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 20, 21, 22, 23 dhe parcelat kadastrale 1339/1, 2, 3, 4 Z.K Bërnice e epërme, në bazë të çertifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, me klasë të kualitetit "VI", kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane" dhe e njëjta do të përfshijë ~ 17,876.30 m² prej sipërfaqes së përgjithshme të parcelave. Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

Rrugët e lagjes "Bërnica Park" duhet të regjistrohet në Kadastër me destinim – **infrastrukturë**.

IX. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullores mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01–0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit.

X. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XI. Në fazën e aplikimit për Leje ndërtimore, parcelat që janë në hipotekë duhet të lirohen nga hipoteka ose dokumentacionit t'i bashkangjiti pëlqimin prej bankës.

XII. Për parcelat kadastrale 1340-11 dhe 1340-14Z.K Bërnice e epërme, të cilat kanë leje ndërtimore dhe me këtë zgjidhje urbane do të riparcelohen duhet të aplikoni për plotësim ndryshim të Vendimit të lejeve ndërtimore, pasi që do të ndryshon sipërfaqja dhe numri i parcelave.

XIII. Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit 05 nr.350-4138 dt.20.03.2013 për caktimin e kushteve ndërtimore dhe i njëjti prodhon efekte juridike nga dita e nxjerrjes së këtij Vendimi.

A r s y e t i m

Aplikuesi, "Chelsea Point" L.L.C nga Prishtina, me kërkesën 05 nr.350/05-12252/21 dt.20.01.2021, ka kërkuar nga Drejtoria e Urbanizimit të Komunës së Prishtinës, plotësimin dhe ndryshimin e Zgjidhjes Urbane të miratuar me Vendimin 05 nr.350-4138 dt.20.03.2013 e kushteve ndërtimore, në lokacionin e përshkruar në pikën I të këtij vendimi.

Bashkangjitur me kërkesë aplikuesi ka prezantuar:

- Kopjen e planit dhe certifikatën e pronësisë për parcelat kadastrale 1338/1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 20, 21, 22, 23, 1339/1, 2, 3, 4, 1340/3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 1341/1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe parcelat 1342/5 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 Z.K Bërnice e epërme,
- Vendimin për caktimin e Kushteve Ndërtimore 05 nr.350-4138 dt.20.03.2013;

- Projekti për plotësimin dhe ndryshimin e zgjidhjes urbane i hartuar nga firma N.N.P''ODA'' me numër të biznesit 601286174 dt.20.07.2015 me pronar Brah Krasniqi.
- Qertifikata e regjistrimit të biznesit të ''Chelsea Point'' L.L.C me nr. 810810871 dt. 12.08.2011, me pronarë Ron Pascalovici, Albert Marcel Zacharia dhe Alan Albert Fox me persona të autorizuar Albert Marcel Zacharia, Alan Albert Fox dhe Bejtullah Krasniqi.
- Autorizimi për përfaqësim Nr.rend LRP 5298/2020 dt. 29.09.2020 i Alan Albert Fox për Ismet Krasniqin.
- Kopja e pasaportës e Alan Albert Fox.
- Kopja e pasaportës e Albert Marcel Zachariah.
- Kopja e pasaportës e Ron Pascalovici.
- Manuali gjeodezik me koordinata për bashkim dhe ndarje të parcelave, nga gjeodeti i licencuar Aziz Mustafa me numër të licencës 28 dt.11.09.2020.

Drejtoria e Urbanizmit bazuar në dokumentacionin e bashkangjitur, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, ka konstatuar se sipas nenit 18 të Ligjit të Ndërtimit nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 10,11,12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017 për përcaktimin e procedurave për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore si dhe leje ndërtimore, ka konstatuar se janë prezantuar të gjitha dokumentet e nevojshme dhe është përfunduar procedura e njoftimit publik. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë (5) ditë në lokacionin në fjalë (prej 21.05.2021 deri më 25.05.2021) dhe meqenëse në ndërkohë në këtë Drejtori nuk është pranuar ndonjë vërejtje apo sugjerim, është vazhduar me shqyrtimin e kërkesës për plotësimin dhe ndryshimin e Zgjidhjes Urbane të miratuar me Vendimin 05 nr.350-4138 dt.20.03.2013 në emër të ''Chelsea Point'' në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, në Bërnice të epërme. Gjatë shqyrtimit të ''Zgjidhjes Urbane'' me plotësime dhe ndryshime është vërtetuar se hartuesi i është përmbajtë kritereve të Planit Zhvillimor Urban të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013 ku kjo zonë është e planifikuar me destinim ''Banim Individual''.

Ky organ, pas shqyrtimit të kërkesës dhe provave tjera të bashkangjitura, identifikimit të gjendjes faktike të lokacionit në terren, ka konsultuar dokumentet e planifikimit hapësinor, për hapësirën ku gjendet lokacioni, si dhe rregullativën ligjore nga lëmi i planifikimit hapësinor dhe nga lëmi i procedurës së përgjithshme administrative, dhe si rezultat ka vendosur të miratojë ndryshimin dhe plotësimin, sipas përshkrimit në pikën I të këtij Vendimi.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Shtojcë: Plani i situacionit -''zgjidhja urbane'' dhe manuali gjeodezik për bashkimin dhe ndarjen e parcelave.

Udhëzim Juridik: Pala e pakënaqur me këtë Vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI.

Ky vendim u printua në 5 (pesë) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesit/Investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie, në dosje të kësaj lënde dhe në dosje të lëndës 05 nr. 350-4138 dt. 21.01.2013.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 nr.350/05-12252/21 dt. 26.05.2021

Zyrtari,
 Mejrushë Sejdullahu



U.d. e udhëheqëses së sektorit,
 Mimoza Berisha Prestreshi



Faqe 4 nga 4

Adresa Rr. UÇK- 2-10 000 Prishtinë-Kosovë
 Telefon. + 381(0)38/230-900





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtine


Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice : 1338-...etj

Zona kadastrale / Katastarska zona: Bernice e Eperme

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1250



Rilevoi / Snimio: Aziz Mustafa
(emri dhe mbiemri i gjeodetit kompanisë/ ime i prezime gjeodeta/ kompani)

Nr. i licencës / Br. licence: 28

Nënshkrimi / Potpis:

Data e rilevimit / Datum snimanja: 20.05.2021



Aprovoi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

Koordinatat e ndarjes		
Nr.	Y	X
1	7513840.06	4729313.94
2	7513841.56	4729312.70
3	7513849.54	4729306.09
4	7513857.52	4729299.48
5	7513863.86	4729294.23
6	7513865.49	4729292.84
7	7513873.38	4729286.12
8	7513881.19	4729279.47
9	7513889.08	4729272.74
10	7513895.66	4729267.14
11	7513897.01	4729266.06
12	7513897.82	4729265.41
13	7513905.09	4729259.58
14	7513913.18	4729253.10
15	7513921.27	4729246.62
16	7513929.47	4729240.29
17	7513931.96	4729238.37
18	7513937.69	4729233.97
19	7513942.63	4729230.17
20	7513945.88	4729227.62
21	7513953.23	4729221.81
22	7513956.42	4729219.27
23	7513962.27	4729214.93
24	7513963.99	4729213.65
25	7513970.60	4729208.75
26	7513974.84	4729205.60
27	7513988.68	4729195.31
28	7513992.86	4729192.61
29	7513992.83	4729179.89
30	7513967.35	4729175.06
31	7513966.08	4729166.66
32	7513959.31	4729161.54
33	7513963.00	4729148.22
34	7513948.30	4729138.42
35	7513941.28	4729138.72
36	7513926.62	4729145.07
37	7513920.46	4729147.74
38	7513909.85	4729159.66
39	7513900.50	4729166.16
40	7513898.02	4729167.89
41	7513884.37	4729174.59
42	7513881.01	4729176.24
43	7513876.91	4729173.60
44	7513864.32	4729180.52
45	7513848.83	4729189.03
46	7513836.89	4729203.93
47	7513822.99	4729221.25
48	7513786.79	4729259.08
49	7513806.79	4729280.63
50	7513811.26	4729285.45

Koordinatat e ndarjes		
Nr.	Y	X
51	7513825.05	4729296.14
52	7513823.20	4729292.45
53	7513823.67	4729288.35
54	7513830.74	4729282.69
55	7513838.85	4729276.23
56	7513846.94	4729269.76
57	7513855.04	4729263.29
58	7513863.14	4729256.82
59	7513871.23	4729250.35
60	7513879.33	4729243.89
61	7513887.43	4729237.42
62	7513895.52	4729230.94
63	7513903.61	4729224.48
64	7513914.16	4729216.05
65	7513924.71	4729207.63
66	7513935.26	4729199.20
67	7513945.80	4729190.77
68	7513956.36	4729182.36
69	7513957.60	4729181.35
70	7513964.66	4729178.51
71	7513955.87	4729163.28
72	7513952.43	4729167.84
73	7513950.70	4729172.44
74	7513949.48	4729173.76
75	7513938.95	4729182.17
76	7513928.40	4729190.60
77	7513917.85	4729199.02
78	7513907.30	4729207.45
79	7513896.76	4729215.88
80	7513888.66	4729222.34
81	7513880.56	4729228.80
82	7513872.45	4729235.26
83	7513864.34	4729241.71
84	7513856.24	4729248.17
85	7513848.13	4729254.63
86	7513831.98	4729267.62
87	7513814.93	4729281.24
88	7513812.71	4729282.36
89	7513810.52	4729282.52
90	7513829.57	4729231.33
91	7513837.66	4729224.87
92	7513845.76	4729218.40
93	7513853.87	4729211.93
94	7513861.96	4729205.47
95	7513870.06	4729199.00
96	7513878.14	4729192.54
97	7513888.70	4729184.12
98	7513899.24	4729175.68
99	7513909.79	4729167.26
100	7513920.34	4729158.84
101	7513930.87	4729150.43



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/Ministry of Infrastructure and Environment
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES/KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtine


Nr. i njësish kadastrale / Br. katastarske jedinice : 1340-11-...el

Zona kadastrale / Katastarska zona: Bemice e Eperme

Numri i lëndës / Broj predmeta: _____

Lloji i njësish kadastrale / Vrsta katastarske jedinice : Parcel

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1: 1000



Rilevoi / Snimio: Aziz Mustafa
(emri dhe mbiemri i gjeodetit kompanisë/ ime i prezime gjeodeta kompanije)



Nr. i licencës / Br. licence: 28

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e rilevimit / Datum snimanja: 20.05.2021

Aprovoi / Usvojto: _____
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime sluzbenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____

